

**DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE
DHE STATISTIKAVE BUJQËSORE**

**ANALIZA E TREGUT TË
KUNGULLIT**

Dhjetor, 2019

Tabela e përmbajtjes

Parathënie	3
1 Tregu i kungullit	3
2 Prodhimtaria vendore	4
3 Zhvillimi i Tregtisë	6
3.1 <i>Importi i kungullit</i>	6
3.2 <i>Eksporti i kungullit</i>	7
3.3 <i>Bilanci tregtar i kungullit</i>	8
4 Çmimet e tregut	9
4.1 <i>Çmimet në tregun vendor</i>	9
4.2 <i>Çmimet e importit</i>	10
5 Madhësia e tregut	11
5.1 <i>Mbështetja e prodhimit të kungullit</i>	11
5.1.1 <i>Pagesat direkte për kungullin</i>	11
6 Konkluzione	12

Parathënie

Kungulli si një kulturë mjaft e vjetër bënë pjesë në sektorin e perimtarisë, sektor i cili ka rendësi të madhe në vendin tonë. Duke parë përfitimet ekonomike që sjell ky sektor, fermerët janë orientuar drejt rritjes së prodhimit, sipërfaqes së mbjellur dhe gjithashtu duke zëvendësuar edhe sasinë e importuar. Qëllimi i kësaj analize është që të përmbledhen të gjitha të dhënat statistikore të cilat pasqyrojnë gjendjen

dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të kulturës së kungullit, ku më gjerësisht shtjellohen të dhënat mbi prodhimtarinë vendore, pasqyra e eksportit dhe importit, çmimet vendore si dhe ato të importuara, madhësia e tregut, zhvillimi i tregtisë, mbështetja nga MBPZHR-ja përmes pagesave direkte dhe masave të zhvillimit rural dhe në fund konkluzionet finale mbi këtë analizë.

1 Tregu i kungullit

Kultura e kungullit përmbush mesatarisht nevojat vendore për konsum, prandaj Kosova vazhdon të importon një sasi të kungullit për përmbushjen e tërësishme të nevojave për konsum vendor. Kungulli si një kulturë e mbjellur tradicionalisht në Kosovë, aktualisht nuk kultivohet në sipërfaqe shumë të madhe. Nga totali i


sipërfaqes së mbjellur me perime prej 17,886 ha në vitin 2018, kungulli ka pjesëmarrje prej 13%. Prodhimtaria mesatare e kungullit për periudhën '14-'18 llogaritet të jetë 16,234 tonë dhe arrin shkallën e vetëmjaftueshmërisë 98%. Sasia mesatare e eksportuar e kungullit për periudhën '14-'18 është 21.3 tonë.

2 Prodhimtaria vendore

Në vitin 2018 Kosova kishte të mbjellur 2,255 ha, me kungull. Prodhimtaria vendore ka pasur luhatje të vazhdueshme gjatë viteve 2014-2018. Gjatë vitit 2018, prodhimtaria vendore ka qenë 20,208 tonë, sasi e cila ka shënuar rënie në krahasim me vitin 2017, ku sasia e prodhuar ka qenë 25,564 tonë, ose shprehur në përqindje

prodhimtaria ishte më e ulët për 21%. Sa i përket rendimentit ishte rreth 9 tonë/ha, në gjithsej 2,255 ha të sipërfaqes së mbjellur për vitin 2018, ku në krahasim me vitin 2017, kishte zvogëlim të rendimentit për 2.3 tonë/ha. Rendimenti më i lartë gjatë periudhës '14 -'18 ishte në vitin 2016, me 14.6 tonë/ha.

Figura 1: Sipërfaqja, prodhimtaria dhe rendimenti i kungullit, 2014-2018




Burimi: ASK - Regjistrimi i Bujqësisë ('14), Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('15,'16,'17,'18), përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Sipërfaqja e kultivuar me kungull sipas regjioneve është paraqitur në figurën në vazhdim, ku shihet se regjioni më sipërfaqe më të madhe të kultivimit me

kungull ishte Prishtina me 20%, pasuar nga Gjilani 18%, Gjakova 15%, Peja dhe Ferizaji me nga 13%, Mitrovica 11% dhe Prizreni 10%.

Figura 2: Sipërfaqja e kultivuar me kungull sipas regjioneve, 2014




Burimi: ASK - Regjistrimi i Bujqësisë ('14), përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Gjithashtu edhe prodhimtaria vendore e kungullit mund të ndahet edhe në bazë të komunave, ku në figurën e mëposhtme janë paraqitur 10 komunat në të cilat më së shumti kultivohet kungulli. Totali i sipërfaqes së kultivuar për këto komuna ishte 794 ha apo 59% e gjithsej sipërfaqes

së kultivuar me kungull. Podujeva karakterizohet me sipërfaqen më të madhe (114 ha), pasuar nga Peja (106 ha) dhe qytetet tjera si Skenderaj, Ferizaj, Viti, Deçani, Rahoveci, Gjlani, Gjakova dhe Kamenica, me sipërfaqe më të vogël.

Figura 3: Sipërfaqja e kultivuar me kungull sipas komunave, 2014



Burimi: ASK - Regjistrimi i Bujqësisë ('14), përpunuar nga DAESB-MBPZHR

3 Zhvillimi i Tregtisë

Në aspektin e tregtisë së kungullit, sasia më e madhe e prodhimitarisë vendore nga fermerët shitet në treg, ndërsa një sasi e vogël përdoret për nevoja tjera. Mund të themi se Kosova mbulon pothuajse tërësisht nevojat e tregut vendor, ku në


vitin 2018 shkalla e vetëmjaftueshmërisë ishte 98%. Sa i përket sasisë së eksportit ka pasur luhatje për periudhën '14-'18, ndërsa nëse krahasojmë vetëm dy vitet e fundit, në vitin 2018 kishte zvogëlim të eksportit për 46%.

3.1 Importi i kungullit

Kungulli i importuar në vitin 2018 ishte 387 tonë, që për dallim nga viti 2017, kishte rritje të sasisë së importuar për 17%. Në periudhën '14-'18, sasia mesatare e importuar e Kungullit ishte rreth 280 tonë. Vlera e importit të kungullit në vitin 2018

ishte rreth 159.9 mijë. €, ku në krahasim me vitin 2017 ishte për 13% më e lartë. Çmimi për njësi (kg) të importuar për vitin 2018 ishte 0.41 €/kg, ndërsa për periudhën '14-'18 çmimi mesatar për njësi të kungullit të importuar ishte 0.52 €/kg.

Figura 4: Importi i kungullit 2014-2018, në tonë (majtas) dhe në '000 € (djathtas)




Burimi: ASK - Regjistrimi i Bujqësisë ('14), Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore ('15,'16,'17,'18), përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Vendet prej të cilave më së shumti është importuar kungulli për periudhën '17-'18 janë: Shqipëria dhe Turqia. Sasia më e madhe e importuar gjatë vitit 2017, ishte nga Shqipëria me pjesëmarrje 57%, pasuar nga Turqia me 42.7% dhe vendet e tjera

me 0.3%. Ndërsa sa i përket vitit 2018, sasia më e madhe e kungullit është importuar nga Shqipëria me 60%, Turqia 38% dhe dy vendet tjera si Greqia dhe Maqedonia me nga 1%.

Figura 5: Importi i kungullit sipas vendeve, 2017 (majtas) dhe 2018 (djathtas)




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

3.2 Eksporti i kungullit

Në vitin 2018, sasia e kungullit të eksportuar ka qenë 33.6 tonë, ku në krahasim me vitin 2017, kjo sasi është zvogëluar për 46%. Duke krahasuar eksportin e kungullit për pesë vitet e fundit, viti 2017 është viti ku ka pasur më së shumti sasi të eksportuar, që arriti në 62.8 tonë. Mesatarja e eksportuar gjatë

këtyre pesë viteve ishte 21 tonë. Vlera e eksportit të kungullit në vitin 2018 ishte 3.7 mijë €, ndërsa çmimi për njësi (kg) të eksportuar në vitin 2018 ishte 0.11 €/kg, ku mesatarja e çmimit për njësi të eksportuar në periudhën '14-'18 ishte 0.19 €/kg.

Figura 6: Eksporti i kungullit 2014-2018, në tonë (majtas) dhe në '000 € (djathtas)




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Eksporti i kungullit sipas vendeve për vitin 2017, është realizuar 100% në Mal të Zi, ndërsa në vitin 2018 me 99% në Mal të Zi dhe vetëm 1% në Rumani.

Në figurën në vazhdim janë paraqitur edhe në mënyrë grafike vendet ku është eksportuar kungulli.

Figura 7: Eksporti i kungullit sipas vendeve, 2017 (majtas) dhe 2018 (djathtas)




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

3.3 Bilanci tregtar i kungullit

Bilanci tregtar i kungullit gjatë periudhës '14-'18 ka pasur luhatje nga viti në vit, po në përgjithësi është karakterizuar me vlerë negative, ku deficitin më të lartë ishte në vitin 2016, (177.3 mijë €). Prodhimtaria vendore në vitin 2018 ka qenë 20,208 tonë, ku gjatë periudhës '14-'18, mesatarisht përmbushja e nevojave të tregut nga prodhimtaria vendore ishte rreth 98%. Sa i përket mbulueshmërisë së importit me eksport, është një përqindje e ulët e

mbulueshmërisë në të gjitha vitet, prandaj kungulli i importuar (edhe pse në sasi të vogël) vazhdon të jetë ende prezent në tregun tonë. Edhe pse bilanci tregtar është negativ sasia e kungullit të importuar është shumë e vogël në krahasim me prodhimtarinë vendore andaj rritja e sipërfaqes së kultivuar me kungull, do të mund të rriste eksportin në mënyrë që të përmirësoj bilancin tregtar dhe të tejkaloj shkallën e plotësimit të nevojave vendore.

Figura 8: Bilanci tregtar i kungullit 2014-2018, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

4 Çmimet e tregut

Kungulli hyn në kategorinë e perimeve si kulturë më e vjetër dhe është i pranishëm në treg zakonisht prej muajt Gusht deri në Mars. Përveç kungullit vendor, në tregun tonë gjendet edhe kungulli i importuar nga vendet tjera. Prodhimtaria e kungullit


përdoret si ushqim për kafshë dhe për konsum njerëzor, Mesatarja e çmimit vendor me shumicë në tregun tonë ishte 0.89 €/kg, ndërsa çmimit me pakicë 1.09 €/kg.

4.1 Çmimet në tregun vendor

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur çmimet maksimale dhe minimale të kungullit në tregun vendor. Çmimi maksimal me shumicë për kulturën e kungullit për periudhën '14-'18 në

tregun vendor ka qenë 1.11 €/kg kurse çmimi minimal 0.75 €/kg. Ndërsa çmimi maksimal vendor në tregun me pakicë ishte 1.27 €/kg, ndërsa çmimi minimal 0.94 €/kg.

Figura 9: Çmimet vendore '14-'18, (€/kg)




Burimi: SIT Kosova, DAESB-MBPZHR

4.2 Çmimet e importit

Çmimet e importit për kungullin me shumicë dhe pakicë për vitet '17-'18, janë paraqitur në figurën e mëposhtme. Çmimi minimal me shumicë ka qenë 0.79 €/kg,

kurse ai maksimal 1.18 €/kg, ndërsa sa i përket çmimeve me pakicë, minimalja ishte 1.02 €/kg dhe maksimalja 1.40 €/kg.

Figura 10: Çmimet e importit '17-'18 (€/kg)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

5 Madhësia e tregut

Në Kosovë sipërfaqja me perime për vitin 2018 vlerësohet se ka qenë 17,886 ha, nga totali i sipërfaqes me perime kungulli merr pjesë 13% me prodhimtari prej gjithsej 20,208 tonë. Tregu i përgjithshëm i kungullit në Kosovë përveç prodhimitarisë vendore përmban edhe kungull të importuar për përmbushje të nevojave për konsum vendor. Përdorimi vendor duke

përfshirë prodhimtarinë vendore dhe importin dhe duke përjashtuar sasinë e eksportuar, në vitin 2018 ka qenë 20,561 tonë. Përveç përdorimit të kungullit për konsum dhe si ushqim i kafshëve, kohëve të fundit ka filluar kultivimi i kungullit enkas për prodhimin dhe tregtimin e farës e cila pas përpunimit krijon një vlerë të shtuar.

5.1 Mbështetja e prodhimitarisë së kungullit

5.1.1 Pagesat direkte për kungullin

Mbështetja përmes pagesave direkte në sektorin e perimeve në fushë të hapur do të kontribuojë në rritjen e të hyrave, cilësinë e prodhimit dhe zvogëlimin e shpenzimeve të prodhimit. Fermerët që janë kultivues të kungullit për të përfituar nga programi i pagesave direkte duhet të kenë të mbjellur së paku 0.50 ha me kungull në fushë të hapur dhe kjo sipërfaqe duhet të jetë në minimum 0.20 ha parcelë e pandarë. Në rast se fermeri merr me qira gjithashtu edhe sipërfaqja e marr me qira duhet të jetë së paku 0.10 ha e pandarë, e dokumentuar përmes kontratës si dhe e kontraktuar në periudhë prej së paku një vit. Në vitin 2018, subvencionimi përmes pagesave direkte është bërë për sipërfaqe të mbjellur me

kungull në fushë të hapur, në vlerë prej 300 €/ha. Fermerët që kultivojnë kungull me sipërfaqe mbi 2 ha, duhet të sjellin dëshminë e sasisë së kungujve të shitur dhe të dorëzuar në ndonjërin nga kompanitë që realizojnë grumbullimin dhe përpunimin e kungullit, gjithashtu duhet të sjellin edhe dëshminë e pagesës nga banka për sasinë e kungullit të shitur. Vlen të ceket se ka edhe prodhimtari të kungullit organik, ku në kuadër të pagesave direkte për bujqësi organike kultura që ka dominuar në vitin 2018, ishte pikërisht kungulli organik. Kungulli organik përveç mbështetjes bazë për perime që ishte 300 €/ha, është mbështetur edhe me 500 €/ha, shtesë i certifikuar si prodhim organik.

6 Konkluzione

Në bazë të të dhënave të analizuara për kulturën e kungullit, shihet se prodhimtaria e kungullit në vitin 2018 ka shënuar rënie për 20%, në krahasim me vitin 2017. Prodhimtaria e kungullit në Kosovë kryesisht përdoret për konsum në kuadër të ekonomive familjare dhe për konsum shtazor, ndërsa në industrinë përpunuese përdoret një sasi më e vogël. Kohëve të fundit prodhimtaria e kungullit është orientuar në përdorim dhe përpunim të fares së kungullit. Kosova mbulon pothuajse në tërësi nevojat e tregut vendor dhe sasia e importuar është shumë e vogël.

Përmbushja e nevojave të tregut nga prodhimtaria vendore me një mesatare prej 98% gjatë periudhës '14 -18, është e kënaqshme, mirëpo rritja e mëtutjeshme e sipërfaqeve të kultivuar me kungull për përdorim në industrinë përpunuese do të krijonte një vlerë të shtuar në sektorin e bujqësisë. Prodhimi i kungullit organik do t'ua mundësonte fermerëve rritjen e të hyrave duke realizuar shitjet me çmim më të lartë si dhe prodhimi Kosovarë do të ketë prezencë më të madhe në tregun e jashtëm.